



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranim / Dorezuar Priljevoj / Predato Received / Delivery	28.07	2022	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	SKP / THCK	4394/2022	Sasia Kolicina Quantity
			1/7



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.493/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti- dhe Jeton Koca anëtarë me Ilire Mehmeti Shqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.493/2022 të datës 31.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati kundër Vendimit me numër të protokollit 02-030/01-6670/22 të datës 30.05.2022 të Komisionit për pranim të kandidatëve, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.493/2022 e datës 31.05.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **ANULOHET** Vendimi me numër 02-030/016858/22 i datës 30.05.2022 i Komisionit për Pranim në Komunën e Shtërpcës si dhe procedura e rekrutimit për pozitën “Inspektor i Shërbimeve Publike” e shpallur sipas Njoftimit të datës 14.02.2022 nga Komuna e Shtërpcës dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Shtërpcës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Komuna e Shtërpcës më datën datës 14.02.2022 ka publikuar njoftimin lidhur me konkursin për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike" i cili ka qenë i hapur për aplikim nga data 01.03.2022 deri me datën 09.03.2022, në të cilin konkurs ka marr pjesë edhe ankuesi. Udhëheqësja e Personelit me datën 25.05.2022 ka shpallur njoftimin me numër të protokollit 02-030/01-6600/22 lidhur me listën me vlerësimin përfundimtar të kandidateve për pozitën " Inspektor i Shërbimeve Publike".

Ankuesi pa kënaqur me Njoftimin me numër të protokollit 02-030101-6600/22 të datës 25.05.2022, të Menaxheres së Personelit në Komunën e Shtërpcës, me datë 26.05.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 02-030/01-6670/22 në Komisionin për Pranim të Kandidateve. Komisioni për Pranim me datën 30.05.2022 ka marr vendimi me numër të protokollit 02-030/01-6858/22 me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit të parashtruar më datë 26.05.2022.

Ankuesi kundër Vendimit me numër të protokollit 02-030/01-6858/22 të datës 30.05.2022 të Komisionit për Pranim në Komunën e Shtërpcës, , me datën 31.05.2022 përmes postes elektronike ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 3169/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 10.06.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtërpcës, ndërsa Komuna e Shtërpcës me datën 24.06.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 07.07.2022 përmes emailit zyrtar ka kërkuar nga Menaxherja e Personelit në Komunën e Shtërpcës prova shtese gjegjësisht ka parashtruar pyetjen se a ka dëshmi nëse diploma e kandidatit të përzgjedhur në Konkursin për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike" është verifikuar në Ministrinë e Arsimit si dhe dëshminë e përvojës së punës së kandidatit të përzgjedhur, ndërsa me datën 08.07.2022, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Shtërpcës, përmes emailit zyrtar është përgjigjur lidhur me pyetjen e parashtruar dhe ka dërguar provat shtesë .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të vendosur me mënyrë meritore lidhur me procedurën e rekrutimit i ka dërguar shkresë /e-mail zyrtar Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) respektivisht Këshilli me e-mail zyrtar të datës 13.07.2022 i është drejtuar Drejtorit të Departamentit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës ku ka kërkuar informate zyrtare dhe sqarim lidhur me verifikimin gjegjësisht nostrifikimin e diplomave të lëshuara nga Shkolla e Lartë e Zveçanit. Ndërsa U.D Drejtori i Departamentit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës përmes emailit me numër të datës 14.07.2022 i është përgjigjur Këshillit se lidhur me verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut duhet ti drejtohem Kryetarit të Komisionit për Verifikim të Diplomave

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës me datën 14.07.2022 përmes emailit zyrtar me kërkesë të njëjtë i është drejtuar Kryetarit të Komisionit për Verifikim të Diplomave ndërsa në të njëjtën datë Këshilli përmes e-mailit ka pranuar përgjigjen nga Kryetari i Komisionit për Verifikim të Diplomave.



Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh natyrën e çështjes me Vendimin Nr.55/2022 të datës 09.06.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Këshilli ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.493/2022 të datës 31.05.2022 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 3169/2022 të datës 31.05.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 02-030/01-6858/22 të datës 30.05.2022; Ankesën me numër të protokollit 02/030/016670/22 të datës 26.03.2022; Njoftimin me numër të protokollit 02-0302101-6600/22 të datës 25.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3373/2022 të datës 10.06.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3686/2022 të datës 24.06.2022; Dokumentin e identifikimit të kandidatit të përzgjedhur; Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Diplomën e datës 30.10.2017 të kandidatit të përzgjedhur; Diplomën e datës 22.04.2013 të ankuesit; Diplomën e datës 17.11.2017 të ankuesit; Certifikatën e datës 06.10.2020; Certifikatën me të cilën dëshmohet se ankuesi prej datës 27.03.2015 deri me 22.06.2015; Certifikatën me numër 144/2019 të datës 01.04.2019; Certifikatën e datës 30.06.2021; Vërtetimin e datës 01.09.2020; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Konkursin me numër të protokollit 02-111/01-1696/22 të datës 14.02.2022; Vendimin me numër të protokollit 02-030/01-5633/22 të datës 04.05.2022; Njoftimi me numër 02-030/01-4793/22 të datës 14.04.2022; Njoftimin për kandidatin fitues me numër të protokollit 02-0301101-6600/22 të datës 25.05.2022; Njoftimin për përfundimin e procedurës së rekrutimit me numër 03-030/017310/22 të datës 06.06.2022; Ankesën me numër 02-030101-6670/22 të datës 26.05.2022; Dokumentin e identifikimit (Letërnjoftimi) i ankuesit; Vendimin me numër 02-030/01-6858/22 të datës 30.05.2022; Renditja përfundimtare me numër të protokollit 02-030/01-6597/22 të datës 25.05.2022; Renditja përfundimtare me numër të protokollit 02-030/01-6597/22 e datës 25.05.2022 e publikuar në Sems; Konfirmimi i datës 07.06.2022 për përfundimin e konkursit; Vendimin me numër të protokollit 3997/2021 të datës 08.07.2022; Emalin e datës 07.10.2022; Kërkesën me numër të protokollit 4715/2019 për informatë zyrtare të datës 09.10.2019; Përgjigjen me numër të protokollit 4971/2019 të datës 22.10.2019; Emalin zyrtar të datës 12.07.2022 me numër të protokollit 4041/2022; Emalin zyrtar të datës 12.07.2022; Emalin zyrtar të datës 08.07.2022; Emalin zyrtar të datës 27.07.2022; Emalin zyrtar të datës 08.07.2022; Emalin zyrtar të datës 08.07.2022; Emalin zyrtar të datës 07.07.2022; Emalin zyrtar të datës 08.07.2022; Vërtetimin për kryerjen e aftësimit profesional; Emalin zyrtar të datës 17.07.2022 me numër të protokollit 4124/2022; Emalin zyrtar të e datës 13.07.2022; Emalin zyrtar të e datës 14.07.2022; Emalin zyrtar të datës 13.07.2022;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka konstatuar se Komuna e Shtërpcës sipas njoftimit të datës 14.02.2022 ka shpallur konkursin publik me afatin për aplikim nga data 01.03.2022 deri me datën 09.03.2022 me numër reference RN00008604 për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike", bazuar në dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe ka marr pjesë deri në fazën e testit me



shkrim te procedurës se rekrutimit, por i njëjti nuk i ka arritur pikwt qw tw merr pjesw nw intervistën me gojw.

Sipas njoftimit të konkursi të datës të datës 14.02.2022 me afatin për aplikim nga data 01.03.2022 deri me datën 09.03.2022 me numër reference RN00008604 për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike", si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Diplomë Universitare ose Shkollë e lartë në fushën përkatëse,*
- *të paktën dy (2) vite përvojë pune.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar katër (4) kandidatë, dhe se të katër kandidatët janë vlerësuar se plotësojnë kriteret e konkursit dhe të njëjtit janë përfshirë ne listën e ngushtë të datës 14.04.2022. Komisioni për praninë i themeluar sipas Vendimit me numër protokollit numër të protokollit 02-030/01-5633/22 të datës 04.05.2022, pas përfundimit të procedurës se intervistimit, me datë 25.05.2022 ka përgatitur listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, sipas të cilës kandidati është listuar si kandidati me më shumë pikë, me gjithsejtë 79 pikë, ndërsa ankuesi është renditur si kandidati i katërt me gjithsejtë 37 pikë sepse i njëjti nuk ka arritur piket qe te merr pjese ne intervistën me goje. Bazuar në listën përfundimtare të Komisionit të Pranimit në Komunën e Shtërpçës, Njësia për Burime Njerëzore, me datë 25.05.2022 ka publikuar njoftimin me numër të protokollit 02-030/01-6600/22 lidhur me listën me vlerësimin përfundimtar të kandidateve për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike, ndërsa me datë 26.05.2022 ankuesi parashtron ankesë me numër të protokollit 02-030/01-6670/22 në Komisionin për Praninë të Kandidateve, kurse Komisioni për Praninë me datën 30.05.2022 ka marr vendimi me numër të protokollit 02-030/01-6858/22 me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit të parashtruar më datë 26.05.2022. Ankuesi kundër Vendimit me numër të protokollit 02-030/01-6858/22 të datës 30.05.2022 të Komisionit për Praninë në Komunën e Shtërpçës, , me datën 31.05.2022 përmes postes elektronike ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 3169/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli në pajtim me mandatin kushtetues dhe ligjor për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë kryerjes së funksioneve dhe përgjegjësisive, gjegjësisht funksionit të shqyrtimit të ankesave ka shqyrtuar procedurën e rekrutimit për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike" si dhe pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse kandidati i përzgjedhur nuk e ka të nostrifikuar Diplomën, dhe ka konstatuar se kriteri i kualifikimit në këtë konkurs ka qenë se: *Diplomë Universitare ose Shkollë e lartë në fushën përkatëse, dhe të paktën dy (2) vite përvojë pune.* Këshilli, gjatë shqyrtimit të procedurës së rekrutimit dhe dosjeve të kandidateve, ka konstatuar se kandidati për përmbushjen e këtij kriteri ka ofruar si dëshmi „Diplome me numër 397 të lëshuar me datë 30.10.2017 nga Shkolla e lartë Teknike, Studime Profesionale në Zvečan, Republika e Serbisë, , me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Shkollën e lartë Teknike me datë 04.11.2014 në programin „mbrojtje nga zjarri“ dhe ka marr titullin „Inxhinjer profesionist për mbrojtje në punë“, mirëpo nuk ka dëshmi që të njëjtën Diplome e ka të nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 07.07.2022 përmes emailit zyrtar ka kërkuar nga Menaxherja e Personelit në Komunën e Shtërpçës prova shtese gjegjësisht i ka parashtruar pyetjen se a ka ofruar dëshmi kandidati i përzgjedhur lidhur me nostrifikimin e



diplomës konkretisht a është është verifikuar diploma e tij në Ministrinë e Arsimit dhe po ashtu ka kërkuar dhe dëshminë e përvojës së punës së kandidatit të përzgjedhur, ndërsa me datën 08.07.2022, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Shtërpçës, përmes emailit zyrtar është përgjigjur lidhur me pyetjen e parashtruar ku ka theksuar se: *“Për sa i përket nostrifikimit të diplomës, kandidati në aplikacionin e tij ka paraqitur diplomën të verifikuar të noteri, sepse ka qene praktik e vendosur deri me tani, pasi që procesi është ndërpre dhe është i pamundur, sepse sipas njoftimit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) procesi i nostrifikimit nga NARIC është ndërprerë për shkak të mungesës së marrëveshjes ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës”* që do të mundësonte njohjen e diplomave në mes Kosovës dhe Serbisë, ndërsa sa i përket përvojës së punës së kandidatit të përzgjedhur Komuna e Shtërpçës kanë bashkangjitur një Vërtetim i cili nuk është i protokolluar dhe nuk ka date të lëshimit .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të vendosur me mënyrë meritore lidhur me procedurën e rekrutimit i ka dërguar shkresë /e-mail zyrtar Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) respektivisht Këshilli me e-mail zyrtar të datës 13.07.2022 i është drejtuar Drejtorit të Departamentit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës , ku ka kërkuar informate zyrtare dhe shpjegim duke ja bashkangjitur edhe diplomën e kandidatit të përzgjedhur lidhur me verifikimin gjegjësisht nostrifikimin e këtyre diplomave , gjegjësisht diplomat e tilla si janë trajtuar, a janë të licencuara dhe si rrjedh procedura e verifikimit nga ana e Ministrisë së Arsimit për Njohjen e saj. Ndërsa U.D i Drejtorit të Departamentit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës përmes emailit të datës 14.07.2022 i është përgjigjur Këshillit se lidhur me verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut duhet ti drejtohem Kryetarit të Komisionit për Verifikim të Diplomave

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës me datën 14.07.2022 përmes emailit zyrtar me kërkesë të njëjtë i është drejtuar Kryetarit të Komisionit për Verifikim të Diplomave

ndërsa ne të njëjtën date Këshilli përmes emailit ka pranuar përgjigjen nga Kryetari i Komisionit për Verifikim të Diplomave me tekstin në vijim: Ne rrjedhën e kërkesës së mëposhtme , j7u njoftoj qe Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, ne pajtim me Rregulloren(QKR)-Nr.21./2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qellim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike, ka qenë kompetent vetëm për shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës së Veriut, që nga viti 2001. Diploma për të cilën kërkohet informatë ( E shkollës së Lartë në Zveçan) nuk ka qenë në kompetenca të Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut dhe Komisioni nuk i ka verifikuar këto diploma”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar përgjigjen zyrtare nga Komuna e Shtërpçës , Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Komisioni për Verifikim të Diplomave, sipas të cilëve kandidati në fjale nuk e ka plotësuar kriterin e kualifikimit gjegjësisht nuk e ka të nostrifikuar diplomën, andaj në bazë të kësaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton që Njësia e Burimeve Njerëzor me rastin e përfshirjes së kandidatit të përzgjedhur në listën e ngushte ka vepruar në kundërshtim me nenin 15 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se „ 1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që



*ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë', ndërsa Komisioni i Pranimit nuk ka respektuar dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është theksuar se: Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, .... bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive.*

Po ashtu, Kolegji nga shkresat e lëndës ka konstatuar se me Vendimin me numër protokollit 02-030/01-5633/22 të datës 04.05.2022, të Shefit të Personelit për themelimin e Komisionit të Pranimit nuk janë përcaktuar edhe zëvendësuesit e anëtarëve të Komisionit të Pranimit ashtu siç përcaktohet me neni 18 paragrafi 6 ndërlidhur me nenin 17 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave konstaton se procedura e rekrutimit për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike" e shpallur nga Komuna e Shtërpcës është zhvilluar në kundërshtim me nenin 34 paragrafin 6 nën paragrafin 6.1 dhe paragrafin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 15 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe neni 18 paragrafi 6 ndërlidhur me nenin 17 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, e meqenëse janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale gjatë zhvillimit të kësaj procedure të rekrutimit, Kolegji në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 3 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje procedurale dhe shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedure e paligjshme, kështu që Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka konstatuar se organi i punësimit Komuna e Shtërpcës, pas pranimit të Vendimit të Këshillit është e obliguar që të ndërmerr veprimet administrative me qëllim të zbatimit të obligimeve ligjore që rrjedhin sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e Vendimit të Këshillit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.493/2022**

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

  
Procesmbajtëse

**Malore-GASHI BAJRAKTARI**

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunë së Shtërpcës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Shtërpcës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.